




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	31.03.2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	Zyra Koordinuese e Kuvendit te Republikës se Kosovës
CC:	Komisioni Ad-hoc Parlamentare
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	<i>per</i> Hasan Preteni, <i>Ar</i> Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me kërkesën për sqarimin e gjendjes se mundshme të konfliktit të interesit



Të nderuar.

Në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1 nënparagrafi 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 (paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 dhe 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me kërkesën tuaj, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar kërkesën nga, Komisionit Ad-hoc Parlamentar I themeluar me Vendim te Kuvendit te Kosovës për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar te Komisionit te Pavarur për Media.me numër të protokollit 03-1154 /14, me të cilën është kërkuar nga ne si autoritet kompetent për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, të sqarohet neni 12,

paragrafi 1.6 i Ligjit për KPM-ne nr 04/L-44 si dhe nenit 4 paragrafi 1.13 I ligjit Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Përmes kësaj shkrese ju njoftojmë se Agjencia kundër Korrupsionit është institucion i pavarur të cilit me ligj i janë besuar përgjegjësi të veçanta. Sipas nenit 5 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia është autoritet qendror i cili ndër të tjera bën edhe mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit si dhe ndërmerr masat e parapara ligjore.

Rrjedhimisht, çështja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik është e rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas shqyrtimit të kërkesës suaj, në të cilën kërkon interpretimin për disa pika të ligjeve që juve ju intereson, ju njoftojmë se bazuar në kompetencën dhe autoritetin tonë të dhënë me ligj, ne mund të paraqesim vetëm opinionin lidhur me çështjen e ngritur me pa qartësinë tuaj lidhur me neni, 12. paragrafi 1.6 të ligjit nr. 04/L-44 Për Komisionin e Pavarur Te Mediave, pasi që është pjesë që lidhet me interesat financiare dhe përfaqësimin e tyre, si dhe pikën 1.9 që lidhet me aktivitet që mund të konsiderohen të jenë në kundërshtim dhe që mund të paraqesin Konflikt të Interesit bazuar në ligjin në fuqi nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Ju njoftojmë se në kuptim të neni 4 të ligjit Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik janë parapare ushtruesit e funksioneve publike që janë objekt i Trajtimit të ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Andaj bazuar në këtë dispozitë të gjithë personat që ushtrojnë këto funksione konsiderohen zyrtarë të lartë dhe kanë për obligim parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik duke respektuar detyrimet, rregullat, kufizimet që rrjedhin në ushtrimin e funksionit publik.

Po ashtu ju njoftojmë se bazuar në nenin 7 paragrafi 8 i po këtij ligji ndër të tjera thotë se, zyrtari i lartë nuk duhet të lejoj që interesat e tij private të bien në konflikt me funksionin e tij. Ai duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, apo i mundshëm.

Ndërsa neni 16. Paragrafi 1 i ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik; përcakton kufizimet për zyrtarin e lartë 16.1. zyrtari i lartë publik nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhuese në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, përjashtuar subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet për shkak të funksionit.

Andaj, duke dhënë opinionin tonë lidhur me çështjen e ngritur nga ju për pozitën e kandidatit për anëtar të Komisionit të Pavarur për Media, të cilën ka aplikuar kandidat i cili në bazë të shkresave dhe dokumenteve përcjellëse të dërguara nga ju ka qenë autore dhe kryeredaktore e 48 dokumentareve televizive nga cikli i Dokumentarëve "Gratë dhe Drejtësia" produksion i OJQ-Smile, e financuar nga Ambasada e Norvegjisë në Kosovë, të cilat dokumentare janë emituar në Radio Televizionin e Kosovës, pasi që RTK ka nënshkruar memorandumën e mirëkuptimit me këtë OJQ, konsiderojmë se e drejta e për të aplikuar për këtë funksion bazuar në shkresat përcjellëse si dhe trajtimin e provave që posedojmë në këtë fazë lidhur me këtë proces mund të themi se nuk shihet se ka elemente që bien në kundërshtim me ligjin për Parandalimin e

Konfliktit të Interesit në Ushtrim të Funksionit Publik, e që lidhet me dispozitën përkatëse të ligjit nr. 04/L-44 për KPM respektivisht nenit 12 pika 1.6 dhe 1.9 të këtij ligji.

Mirëpo ju njoftojmë se gjithmonë kur mund të paraqiten rrethana dhe fakte të reja Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur paraqiten rrethana të reja.

Bazuar në këtë, iu rekomandojmë që të veproni konform këtij opinionit të bazuar në ligjin në fuqi.

Me respekt!